




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



DATE/A:	02.11.2017
REFERENC-Ë:	AKK-DPK- 03-03-3520/17
PËR/ZA/TO:	z. Isa OSMANKAJ, Koordinator i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Prizrenit
CC:	z. Ramadan MUJA, Kryetar i Komunës së Prizrenit
NGA/OD/FROM:	Shqip HAVOLLI, <i>Shqip</i> Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Ndërtimi i 4 rrugëve me elemente betoni në lagjen 11 marsi në Prizren "

I nderuari z. Osmankaj,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par. 1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin " Ndërtimi i 4 rrugëve me elemente betoni në lagjen 11 marsi në Prizren " me numër prokurimi: 622-17-4805-521 dhe me nr. të brendshëm: 622-17-171-521, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Ndërtimi i 4 rrugëve me elemente betoni në lagjen 11 marsi në Prizren " me numër prokurimi: 622-17-4805-521 dhe me nr. të brendshëm: 622-17-171-521, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin nr. 04/L -237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejshme Agjencia), me datë 27.10.2017, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-3520/17*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "Ndërtimi i 4 rrugëve me elemente betoni në lagjen 11 marsi në Prizren" me numër prokurimi: 622-17-4805-521 dhe me nr. të brendshëm: 622-17-171-521, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues, Komuna e Prizrenit.

Agjencia duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka hapur këtë rast nën dyshimin se Autoriteti kontraktues me rastin e hartimit të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit ka bërë shkelje të nenit 69 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik. Agjencia fillimisht ka trajtuar dhe analizuar dokumentet në dispozicion në platformën **E-prokurimi** si: njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe pjesën e specifikimeve teknike.

Agjencia, pasi ka trajtuar dokumentet në dispozicion ka konstatuar se Autoriteti kontraktues ka paraparë procedurën e hapur, kontratë të llojit punë ndërtimore me vlerë të mesme të kontratës. Pas, analizimit të njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, Agjencia ka vërejtur se vlera e parashikuar e kësaj kontrate është 50.000,00 €, ndërsa tek rubrika III.2.4. e kapacitetit teknik profesional, kërkesa 1 Autoriteti kontraktues ka kërkuar listën e projekteve të natyrës së kontratës të realizuara në tri vitet e fundit (2014,2015 dhe 2016) e vërtetuar nga Operatorët ekonomik, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit, vlera minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 750.000,00 €. **Kërkesë kjo për të cilën konsiderojmë se është në kundërshtim me nenin 68 dhe 69 të Ligjit në fuqi për prokurimin publik në Republikën e Kosovës.**

Sipas Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik, për ta vërtetuar aftësinë teknike ose profesionale, Autoriteti kontraktues mund të kërkojë vlera minimale në lidhje me furnizimet, shërbimet dhe punët në 3 vitet e fundit listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktivitetëve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktivitetëve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; sa herë që është e mundur, autoriteti kontraktues mund të obligohet që të dakordohet me autoritetin publik kompetent në Kosovë ose në vendin tjetër që kopjet e certifikatave përkatëse t'ia paraqes drejtpërdrejtë autoritetit kontraktues.

Kur përveç qarkullimit minimal, është i nevojshëm një qarkullim i caktuar minimal në fushën specifike të mbuluar nga kontrata, qarkullimi i tillë nuk duhet të tejkalojë kufizimin ligjor një pikë pesë (1.5) herë vlerën e parashikuar të kontratës.

Në nenin 69 paragrafi 1 është paraparë që “ **Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuar në këtë nen** “.

Veprimet e Autoritetit kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi, nenin 68 Gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenin 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale i Ligjit Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr materialin tenderik.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !